



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

UDHËZIM ADMINISTRATIV MD - NR. 02/2023
PËR AUTOPSINË MJEKO LIGJORE DHE PROCEDURAT TJERA TË
EKZAMINIMEVE MJEKO LIGJORE¹

ADMINISTRATIVE INSTRUCTION MoJ - No. 02/2023
FOR FORENSIC AUTOPSY AND OTHER FORENSIC EXAMINATION PROCEDURES²

ADMINISTRATIVNOG UPUTSTVA MP - Br. 02/2023
ZA FORENZIČKU OBDUKCIJU I DRUGE POSTUPKE FORENZIČKOG
ISPITIVANJA³

¹ Udhëzim Administrativ MD - nr. 02/2023 për autopsinë mjeko ligjore dhe procedurat tjera të ekzaminimeve mjeko ligjore, i nënshkruar nga Ministrija e Drejtësisë, më datë 23.03.2023.

² Administrative Instruction MoJ - No.02/2023 for forensic autopsy and other forensic examination procedures, signed by Minister of Justice, date 23.03.2023.

³ Administrativnog Uputstva MP - br. 02/2023 za forenzičku obdukciju i druge postupke forenzičkog ispitivanja, je potpisano od strane Ministar Pravde, datum 23.03.2023.

<p>Ministrja e Ministrisë së Drejtësisë,</p> <p>Në mbështetje të Nenit 137 (paragrafi 1) të Kodit Nr.08/L-032 të Procedurës Penale (Gazeta Zyrtare, Nr.24/17 gusht 2022), nenit 9 të Ligjit nr. 05/L-060 për Mjekësinë Ligjore (Gazeta Zyrtare, Nr.11/06 prill 2016), në përputhje me nenin 11, paragrafi 1, nënparagrafin 1.5 të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe bazuar në nenin 8 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.4) të Rregullores (QRK) -Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021), e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr.04/2021 (10.09.2021) dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2022, nenit 38 paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare nr. 15, e datës 12.09.2011),</p> <p>Nxjerrë:</p> <p>UDHËZIM ADMINISTRATIV MD - NR. 02/2023 PËR AUTOPSINË MJEKO LIGJORE DHE PROCEDURAT TJERA TË EKZAMINIMEVE MEJKO LIGJORE</p>	<p>Minister of the Ministry of Justice,</p> <p>Pursuant to Article 137 (paragraph 1) of Criminal Procedure Code No. 08/L-123 (Official Gazette, No. 24/17 August 2022), Article 9 of Law no. 05/L-060 on Forensic Medicine (Official Gazette of the Republic of Kosovo, No. 11/06 April 2016), pursuant to Article 11, paragraph 1, subparagraph 1.5 of Law No. 08/L-117 on the Government of the Republic of Kosovo, as well as pursuant to Article 8 (paragraph 1, sub-paragraph 1.4) of Regulation (GRK) - No. 02/2021 on the Areas of Administrative Responsibility of the Office of the Prime Minister and Ministries (30.03.2021), as amended and supplemented by Regulation (GRK) No. 04/2021 (10.09.2021) and Regulation (GRK)- No. 03/2022, Article 38 paragraph 6 of Regulation No. 09/2011 on Rules and Procedure of the Government (Official Gazette no. 15, dated 12.09.2011),</p> <p>Issues:</p> <p>ADMINISTRATIVE INSTRUCTION MoJ - No.02/2023 FOR FORENSIC AUTOPSY AND OTHER FORENSIC EXAMINATION PROCEDURES</p>	<p>Ministarka Ministarstva Pravde,</p> <p>Na osnovu člana 137 (stav 1) Zakona o krivičnom postupku br. 08/L-123 (Službeni list, br. 24/17. avgusta 2022. godine), člana 9. Zakona br. 05/L-060 o sudskoj medicini (Službeni list Republike Kosovo, br. 11/06 april 2016), u skladu sa članom 11, stav 1, podstav 1.5 Zakona br. 08/L-117 o Vladi Republike Kosova, kao i na osnovu člana 8 (stav 1, podstav 1.4) Uredbe (VRK) - br. 02/2021 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstava (30.03.2021.), izmenjena i dopunjena Uredbom (VRK) br. 04/2021 (10.09.2021) i Uredbom VRK-a br. 03/2022, člana 38. stav 6. Uredbe br. 09/2011 o Poslovniku Vlade (Službeni list br. 15 od 12.09.2011),</p> <p>Izdaje:</p> <p>ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO MP - br. 02/2023 ZA FORENZIČKU OBDUKCIJUIDRUGE POSTUPKE FORENZIČKOG ISPITIVANJA</p>
--	--	--

<p align="center">KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</p>	<p align="center">CHAPTER I GENERAL PROVISIONS</p>	<p align="center">POGLAVLJE I OPŠTE ODREDBE</p>
<p align="center">Neni 1 Qëllimi</p> <p>Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen standardet dhe procedurat për kryerjen e autopsisë mjeko ligjore dhe ekzaminimeve tjera mjeko ligjore, organin përgjegjës për kryerjen e tyre, përfshirë interpretimin e gjetjeve dhe dhënien e mendimit, si dhe përgjegjësitë e ekspertit mjeko ligjor.</p>	<p align="center">Article 1 Purpose</p> <p>This Administrative Instruction defines the standards and procedures for performing forensic autopsy and other forensic examinations, the body responsible for their performance, including the interpretation of findings and giving an opinion, as well as the responsibilities of the forensic expert.</p>	<p align="center">Član 1 Svrha</p> <p>Ovo Administrativno uputstvo definiše standarde i procedure za obavljanje forenzičke obdukcije i drugih forenzičkih ispitivanja, organ koji je odgovoran za njihovo obavljanje, uključujući tumačenje nalaza i davanje mišljenja, kao i odgovornosti sudskog veštaka.</p>
<p align="center">Neni 2 Fushëveprimi</p> <p>Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ zbatohen për Institutin e Mjekësisë Ligjore (në tekstin e mëtejme: Instituti) dhe ekspertët mjeko ligjor.</p>	<p align="center">Article 2 Scope</p> <p>The provisions of this Administrative Instruction apply to the Institute of Forensic Medicine (hereinafter referred to as: the Institute) and forensic experts.</p>	<p align="center">Član 2 Delokrug</p> <p>Odredbe ovog Administrativnog uputstva primenjuju se na Institut za Sudsku Medicinu (u daljem tekstu: Institut) i sudske veštace.</p>
<p align="center">Neni 3 Kryerja e ekzaminimeve mjeko ligjore dhe ruajtja e dinjitetit të subjektit të ekzaminimit</p> <p>1. Ekspertët mjeko ligjor kryejnë detyrat e tyre në mënyrë objektive, të pavarur dhe të paanshme në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p align="center">Article 3 Conducting forensic examinations and maintenance of the dignity of the subject of examination</p> <p>1. Forensic experts perform their duties objectively, independently and impartially in accordance with the legislation in force.</p>	<p align="center">Član 3 Sprovođenje forenzičkih ispitivanja i održavanje dostojanstva subjekta ispitivanja</p> <p>1. Sudski veštaci svoje poslove obavljaju objektivno, nezavisno i nepristrasno u skladu sa važećim zakonima.</p>

<p>2. Ekzaminimi mjeko ligjor dhe të gjitha veprimet përkatëse kryhen në përputhje me etikën profesionale dhe duke respektuar dinjitetin e subjektit të ekzaminimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 4 Ruajtja e fshehtësisë</p> <p>Informacioni i mbledhur gjatë ekzaminimeve mjeko ligjore, raporti i autopsisë mjeko ligjore dhe raporti i ekzaminimeve tjera mjeko ligjore, si dhe të gjitha shkresave tjera lidhur me këto ekzaminime ruhen nga qasja e personave të paautorizuar në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 5 Gjuha</p> <p>1. Personi që merr pjesë në ekzaminim mjeko ligjor, i cili nuk e flet ose nuk e kupton gjuhën në të cilën kryhet ekzaminimi, ka të drejtë të flasë gjuhën e vet dhe të jetë i informuar nëpërmjet përkthimit pa pagesë me faktet, provat dhe procedurën. Përkthimi duhet të jetë i cilësisë së mjaftueshme për të garantuar paanshmërinë e procedurës dhe sigurohet përmes një përkthyesi të pavarur.</p> <p>2. Sigurimi i interpretuesit të shenjave do të bëhet në rastet kur kemi të bëjmë me persona me nevoja të veçanta.</p>	<p>2. The forensic examination and all related actions are performed in accordance with professional ethics and respecting the dignity of the subject of the examination.</p> <p style="text-align: center;">Article 4 Confidentiality</p> <p>The information collected during forensic examinations, the forensic autopsy report and other forensic examinations report, as well as all other documents related to these examinations are protected from access by unauthorized persons in accordance with the relevant legislation in force.</p> <p style="text-align: center;">Article 5 Language</p> <p>1.The person undergoing a forensic examination, who does not speak or understand the language in which the examination is conducted, has the right to speak his/her own language and be informed of the facts, evidence and procedure through translation free of charge. The translation must be of sufficient quality to guarantee the impartiality of the procedure and shall be provided through an independent translator.</p> <p>2. Provision of a sign interpreter will be made in cases where we are dealing with persons with disabilities.</p>	<p>2. Forenzičko ispitivanje i sve povezane radnje obavljaju se u skladu sa profesionalnom etikom i uz poštovanje dostojanstva subjekta ispitivanja.</p> <p style="text-align: center;">Član 4 Poverljivost</p> <p>Podaci prikupljeni tokom forenzičkih ispitivanja, nalaz forenzičke obdukcije i drugih forenzičkih ispitivanja, kao i svi ostali dokumenti u vezi sa ovim pregledima zaštićeni su od pristupa neovlašćenih lica u skladu sa relevantnim zakonima na snazi.</p> <p style="text-align: center;">Član 5 Jezik</p> <p>1. Lice na ispitivanju, a koje ne govori i ne razume jezik na kojem se obavlja ispitivanje, ima pravo da govori svoj jezik i da bude upoznat sa činjenicama, dokazima i procedurom putem besplatnog prevoda. Prevod mora biti dovoljno kvalitetan da garantuje nepristrasnost postupka i biće obezbeđen preko nezavisnog prevodioca.</p> <p>2.U slučajevima kada se radi o osobama sa invaliditetom, biće obezbeđen i znakovni tumač.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 6 Zinxhiri i ruajtjes</p>	<p style="text-align: center;">Article 6 Chain of Custody</p>	<p style="text-align: center;">Član 6 Lanac čuvanja dokaza</p>
<p>1. Zinxhiri i ruajtjes mundëson monitorimin dhe kontrollimin e provave fizike dhe informacionit që lidhen me ekzaminimet mjeko ligjore të cilat garantojnë integritetin, identitetin, ruajtjen, sigurinë dhe përshtatshmërinë e tyre gjatë tërë procesit të hetimit.</p> <p>2.Zinxhiri i ruajtjes sigurohet përmes evidentimit të duhur ose dokumentimit të transferimit ndërmjet personave përgjegjës, si dhe të ndryshimeve të bëra nga secili prej tyre nga momenti i marrjes deri në hallkën e fundit të zinxhirit me urdhër të autoritetit kompetent.</p> <p>3.Dokumentimi i zinxhirit të ruajtjes mundëson monitorimin e kushteve në të cilat provat ose informacionet janë ruajtur dhe proceduar duke përfshirë regjistrimin e emrave të personave përgjegjës, kohën kur ata kanë pasur qasje në provat apo informacionet dhe veprimet e kryera në to.</p> <p>4.Secili zyrtar i Institutit obligohet të plotësojë me rregull, në mënyrë të qartë dhe me kohë zinxhirin e ruajtjes së çdo mostre apo dëshmie që merr, dorëzon apo trajton.</p>	<p>1. The chain of custody allows the monitoring and control of physical evidence and information associated to forensic examinations that guarantee the integrity, identity, preservation, security and suitability throughout the investigation process.</p> <p>2. The chain of custody is ensured through the appropriate record or documentation of transfers between the responsible persons, as well as of the changes introduced by each of them, from the moment of collection until the last link of the chain by order of the competent authority.</p> <p>3. The documentation of the chain of custody shall allow to monitor the conditions in which the evidence or information was retained and processed, by recording the names of the responsible persons, the time when they gained access to the evidence or information and the actions carried out on them.</p> <p>4.Each official of the Institute shall be obliged to properly, clearly and timely complete the chain of custody of any sample or evidence received, handed over or handled by them.</p>	<p>1.Lanac čuvanja dokaza omogućava praćenje i kontrolu fizičkih dokaza i informacija povezanih sa forenzičkim pregledima koji garantuju integritet, identitet, očuvanje, sigurnost i prikladnost tokom procesa istrage.</p> <p>2.Lanac čuvanja dokaza se obezbeđuje odgovarajućom evidencijom ili dokumentacijom o prenosima između odgovornih lica, kao i promenama koje svako od njih uvede, od trenutka prikupljanja do poslednje karike lanca po nalogu nadležnog organa.</p> <p>3.Dokumentacija lanca čuvanja dokaza omogućava praćenje uslova u kojima su dokazi ili informacije čuvani i obrađivani, uz evidentiranje imena odgovornih lica, vremena kada su dobili uvid u dokaze ili informacije i radnje koje su na njima izvršene.</p> <p>4.Svaki službenik Instituta dužan je da pravilno, jasno i blagovremeno završi lanac čuvanja dokaza nad svakim dokazom ili dokaznim materijalom koji je primio, predao ili sa kojim rukuje.</p>

<p align="center">KAPITULLI II KRYERJA E AUTOPSISË MJEKO LIGJORE</p>	<p align="center">CHAPTER II PERFORMING FORENSIC AUTOPSY</p>	<p align="center">POGLAVLJE II VRŠENJE FORENZIČKE OBDUKCIJE</p>
<p align="center">Neni 7 Rastet kur kërkohet kryerja e autopsisë mjeko ligjore</p> <p>1. Autopsia mjeko ligjore në pajtim me Ligjin për Mjekësinë Ligjore dhe dispozitat përkatëse kryhet por nuk kufizohet në këto raste:</p> <p>1.1. vrasja ose vrasja e dyshimtë;</p> <p>1.2. vdekja e papritur dhe në rrethana të paparashikueshme, duke përfshirë edhe vdekjen e papritur të foshnjave;</p> <p>1.3. cenimi i të drejtave të njeriut siç është dyshimi për torturë ose për çfarëdo lloj të keqtrajtimit;</p> <p>1.4. vetëvrasja ose dyshimi në vetëvrasje;</p> <p>1.5. dyshimi në mjekim të pandërgjegjshëm;</p> <p>1.6. aksidentet, si ato rrugore, profesionale ose në amvisëri;</p>	<p align="center">Article 7 Cases where a forensic autopsy is required to be performed</p> <p>1. In accordance with the Law on Forensic Medicine and the relevant provisions, the forensic autopsy shall be performed but not limited to the following cases:</p> <p>1.1. homicide or suspicious homicide;</p> <p>1.2. sudden death and in unpredictable circumstances, including sudden death of infants;</p> <p>1.3. violation of human rights such as suspicion of torture or any other form of ill treatment;</p> <p>1.4. suicide or suspicious suicide;</p> <p>1.5. suspicion in medical malpractice;</p> <p>1.6. accidents, whether transportation, occupational or domestic;</p>	<p align="center">Član 7 Slučajevi u kojima je potrebna forenzička obdukcija</p> <p>1. U skladu sa Zakonom o Sudskoj Medicini i relevantnim odredbama, forenzička obdukcija će se obaviti, ali bez ograničenja, u sledećim slučajevima:</p> <p>1.1. ubistvo ili u slučaju sumnje na ubistvo;</p> <p>1.2. nenadna smrt i u nepredvidivim okolnostima, uključujući iznenadnu smrt dojenčadi;</p> <p>1.3. kršenje ljudskih prava kao što je sumnja na torturu ili bilo koji drugi oblik zlostavljanja;</p> <p>1.4. samoubistvo ili sumnjivo samoubistvo;</p> <p>1.5. sumnja u grešku lekara;</p> <p>1.6. nesreće, bilo u transportu, na radu ili u domaćinstvu;</p>

<p>1.7. sëmundjet profesionale;</p> <p>1.8.fatkeqësitë teknologjike ose mjedisore;</p> <p>1.9.vdekja në arrest ose vdekja e ndërlidhur me aktivitete policore ose ushtarake;</p> <p>1.10.trupat e paidentifikuar ose të skeletizuar.</p> <p style="text-align: center;">Neni 8 Kryerja e autopsisë mjeko ligjore</p> <p>1. Autopsia mjeko ligjore kryhet me urdhër të Prokurorit të Shtetit apo Gjykatës.</p> <p>2. Autopsia mjeko ligjore kryhet në Institut.</p> <p>3. Përgjashtimisht, autopsia mjeko ligjore me urdhër të Gjykatës apo Prokurorit të Shtetit mund të kryhet edhe jashtë lokaleve përkatëse të Institutit, pasi që sigurohen kushte të përshtatshme për një gjë të tillë.</p> <p>4. Qëllimi i autopsisë mjeko ligjore është të përcaktojë, për aq sa është e mundur, identifikimin, kohën e vdekjes, shkaku e vdekjes, mekanizmin e vdekjes dhe mënyrën e vdekjes.</p>	<p>1.7. occupational disease;</p> <p>1.8.technological or environmental disasters;</p> <p>1.9. death in custody or death associated with police or military activities;</p> <p>1.10. unidentified or skeletonized bodies.</p> <p style="text-align: center;">Article 8 Performing forensic autopsy</p> <p>1. The forensic autopsy is performed by order of the State Prosecutor or the Court.</p> <p>2.The forensic autopsy is performed at the Institute.</p> <p>3. Exceptionally, by order of the Court or the State Prosecutor, the forensic autopsy can also be carried out outside the relevant premises of the Institute, provided that appropriate conditions are established.</p> <p>4. The purpose of the forensic autopsy is to establish, to the extent possible, identification, time of death, cause of death, mechanism of death, and manner of death.</p>	<p>1.7. profesionalna bolest;</p> <p>1.8. tehnološke ili ekološke katastrofe;</p> <p>1.9. smrt u pritvoru ili smrt povezana sa policijskim ili vojnim aktivnostima;</p> <p>1.10. neidentifikovana ili skeletizovana tela.</p> <p style="text-align: center;">Član 8 Vršenje forenzičke obdukcije</p> <p>1. Forenzička obdukcija se vrši po nalogu državnog tužioca ili suda.</p> <p>2. Forenzička obdukcija se obavlja u Institutu.</p> <p>3.Izuzetno, po nalogu suda ili državnog tužioca, forenzička obdukcija se može obaviti i van odgovarajućih prostorija Instituta, pod uslovom da se stvore odgovarajući uslovi.</p> <p>4. Svrha forenzičke obdukcije je da se utvrdi, koliko je to moguće, identifikaciju, vreme smrti, uzrok smrti, mehanizam smrti i način smrti.</p>
---	--	--

<p>5. Autopsia mjeko ligjore nuk kryhet më herët se gjashtë (6) orë pas konstatimit të vdekjes.</p> <p style="text-align: center;">Neni 9 Ekipi për kryerjen e autopsisë mjeko ligjore</p> <p>1. Ekipi për kryerjen e autopsisë mjeko ligjore përbëhet nga dy mjekë, një teknik i autopsisë dhe një fotograf mjeko ligjor.</p> <p>2. Mjekët që kryejnë autopsinë janë mjekë ligjor, ose njëri mund të jetë mjek ligjor dhe tjetri mjek në specializim.</p> <p>3. Eksperti mjeko ligjor mbikëqyrë dhe është përgjegjës për të gjitha veprimet që ndërmerren gjatë ekzaminimeve mjeko ligjore.</p> <p>4. Eksperti mjeko ligjor ose mjeku në specializim bënë diseksionin e organeve trupore, si dhe konstaton nevojën për diseksione speciale ose analiza shitesë dhe e informon Prokurorin e Shtetit apo Gjykatën që ka lëshuar urdhrin për autopsi.</p>	<p>5. The forensic autopsy is not performed earlier than six (6) hours after the death is declared.</p> <p style="text-align: center;">Article 9 Forensic autopsy performance team</p> <p>1. The forensic autopsy team consists of two doctors, an autopsy technician and a forensic photographer.</p> <p>2. The doctors who perform the autopsy are forensic doctors, or one of them can be a forensic doctor and the other a resident doctor.</p> <p>3. The forensic expert supervises and is responsible for all actions taken during forensic examinations.</p> <p>4. The forensic expert_or resident doctor performs the dissection of the body organs, as well as establishes the need for special dissections or additional examinations and shall report to the State Prosecutor or the Court that issued the autopsy order.</p>	<p>5. Forenzička obdukcija se ne vrši ranije od šest (6) sati nakon proglašenja smrti.</p> <p style="text-align: center;">Član 9 Tim za vršenje forenzičke obdukcije</p> <p>1. Tim za forenzičku obdukciju čine dva doktora, obdukcioni tehničar i forenzički fotograf.</p> <p>2. Doktor koji obavljaju obdukciju su sudski veštaci, ili jedan od njih može biti sudski veštak, a drugi doktor specijalista.</p> <p>3. Sudski veštak nadzire i odgovoran je za sve aktivnosti preduzete tokom forenzičkih ispitivanja.</p> <p>4. Sudski veštak ili doktor specijalista vrši seciranje telesnih organa, kao i utvrđuje potrebu za posebnim seciranjem ili dodatnim pregledima i o tome izveštava državnog tužioca ili organ koji je izdao nalog za obdukciju.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 10 Hetimi në vendin e ngjarjes</p> <p>1. Me urdhër të Prokurorit të Shtetit apo Gjykatës, dhe varësisht nga rasti,</p>	<p style="text-align: center;">Article 10 Scene Investigation</p> <p>1. By order of the State Prosecutor or the Court, and depending on the case, the Institute</p>	<p style="text-align: center;">Član 10 Uvidaj na mestu zločina</p> <p>1. Po nalogu državnog tužioca, a u zavisnosti od slučaja, kontaktira se Institut i, u</p>

<p>kontaktohet Instituti dhe mjeku ligjor kërkohet të shkojë në vendin e ngjarjes ku është gjetur trupi.</p> <p>2. Ekipi për hetimin në vendin e ngjarjes përbëhet nga eksperti mjeko ligjor kujdestar dhe asistenti i morgut në detyrë.</p> <p>3. Në raste të caktuara sipas nevojës dhe me kërkesën e ekspertit mjeko ligjor mund të bëhen pjesë e ekipit për hetimin në vendin e ngjarjes edhe zyrtarë tjerë të Institutit.</p> <p>4. Mjeku ligjor në vendin e ngjarjes:</p> <p>4.1. informohet për të gjitha rrethanat që ndërlidhen me vdekjen;</p> <p>4.2. sigurohet që fotografimi i kufomës bëhet në mënyrë të duhur, duke përfshirë pamjen e përgjithshme dhe fotografitë e detajuara me shkallëzime;</p> <p>4.3.evidenton pozitën e trupit dhe ndërlidhjen e tij me gjendjen e veshjeve, mënyrën e shtangimit kufomor (<i>rigor mortis</i>) dhe shpërndarjen e njollave kufomore (<i>livor mortis</i>), si dhe gjendjen e dekompozimit.</p> <p>4.4.ekzaminon dhe evidenton shpërndarjen dhe formën e shpërndarjes së njollave të gjakut në trupin e vdekur dhe në vendngjarje, si dhe provat tjera</p>	<p>is contacted and the forensic doctor is requested to proceed to the scene where the body is found.</p> <p>2.The team for the investigation at the scene consists of the appointed forensic expert and the morgue assistant on duty.</p> <p>3.In certain cases, according to the need and at the request of the forensic expert other officials of the Institute may also become part of the team for investigation at the scene.</p> <p>4. At the scene, the forensic doctor:</p> <p>4.1.is informed about all the circumstances related to the death;</p> <p>4.2. ensures that the body is photographed properly, including general view and detailed scaled photographs;</p> <p>4.3. records the position of the body and its relationship with the state of clothing, the manner of cadaveric spasm (<i>rigor mortis</i>) and distribution of lividity (<i>livor mortis</i>), as well as the state of decomposition;</p> <p>4.4. examines and records the distribution and form of distribution of blood stains on the dead body and at the scene, as well as of other biological evidence;</p>	<p>zavisnosti od slučaja, od doktora sudske medicine se traži da izađe na lice mesta gde je nastupila smrt.</p> <p>2.Tim za uviđaj na mestu zločina čine imenovani sudski veštak i dežurni pomoćnik mrtvačnice.</p> <p>3.U pojedinim slučajevima, prema potrebi i na zahtev sudskog veštaka, u tim za uviđaj na mestu zločina mogu se uključiti i druga službena lica Instituta.</p> <p>4.Na mestu zločina, sudski veštak:</p> <p>4.1. je obavešten o svim okolnostima u vezi sa smrću;</p> <p>4.2.osigurava da je telo pravilno fotografisano, uključujući opšti prikaz i detaljne fotografije u skaliranoj veličini;</p> <p>4.3. beleži položaj tela i njegov odnos sa stanjem odeće, načinom kadaveričnih grčeva (<i>rigormortis</i>) i bledila (<i>livormortis</i>), kao i stanjem raspadanja nakon smrti;</p> <p>4.4. ispituje i evidentira rasprostranjenost i oblik mrlja krvi na mrtvom telu i na mestu zločina, kao i druge biološke dokaze;</p>
--	---	---

<p>biologjike;</p> <p>4.5.bën ekzaminimin e jashtëm sipërfaqësor të kufomës;</p> <p>4.6. evidenton, përveç rasteve kur trupi është i dekompozuar ose i skeletizuar, temperaturën e ambientit dhe temperaturën rektale, njollat kufomore, shtangimin kufomor si dhe fenomenet tjera kufomore për të përcaktuar kohën e vdekjes;</p> <p>4.7. mbron mikrogjurmët, nëse e vlerëson të nevojshme, si te rastet e dyshimta që ndërlidhen me krimet seksuale, ngulfatjet me duar, vrasjet, etj.</p> <p>5.Nëse Prokurori i Shtetit urdhëron autopsinë, trupi transportohet në morgun e Institutit ku mbahet në kushte adekuate, në temperaturë të ulët, në gjendje të patrazuar dhe me qasje të kufizuar.</p> <p style="text-align: center;">Neni 11 Procedura para autopsisë</p> <p>1. Para se të filloj autopsia, mjeku ligjor pranon urdhrin për autopsi nga Prokurori i Shtetit apo Gjykata, i cili përmban informatat për rastin, si dhe pyetjet e detajuara për ekspertin mjeko ligjor.</p> <p>2. Para autopsisë, ekspertit mjeko ligjor i</p>	<p>4.5.performs the external surface examination of the body;</p> <p>4.6. records, except in cases where the body is in an advanced state of decomposition or skeletonized, the ambient temperature and rectal temperature, lividity, cadaveric spasm as well as other cadaveric phenomena, to establish the time of death;</p> <p>4.7. protects microprints, if they deem it necessary, such as in suspicious cases related to sexual crimes, strangling, homicides, etc.</p> <p>5. If the State Prosecutor orders an autopsy, the body is transported to the morgue of the Institute where it is kept in appropriate conditions, at a low temperature, in an undisturbed state and under limited access.</p> <p style="text-align: center;">Article 11 Pre-autopsy procedure</p> <p>1.Prior to autopsy commencement, the forensic doctor receives an autopsy order from the State Prosecutor or the Court, which contains information about the case, as well as detailed questions for the forensic doctor.</p> <p>2.Prior to autopsy, the forensic expert is</p>	<p>4.5. vrši pregled spoljne površine tela;</p> <p>4.6. evidentira, osim u slučajevima kada je telo razgrađeno ili skeletizovano, temperaturu okoline i rektalnu temperaturu, lividnost, kadaverični grč kao i druge kadaverične pojave, kako bi se utvrdilo vreme smrti;</p> <p>4.7. štiti mikrootiske, ako smatra da je to potrebno, kao na primer u sumnjivim slučajevima u vezi sa seksualnim zločinima, davljenjem, ubistvima itd.</p> <p>5.Ukoliko državni tužilac naloži obdukciju, telo se transportuje u mrtvačnicu Instituta gde se čuva u odgovarajućim uslovima, na niskoj temperaturi, u nesmetanom stanju i uz ograničen pristup.</p> <p style="text-align: center;">Član 11 Procedura koji se vrše pre obdukcije</p> <p>Pre početka obdukcije, sudski veštak dobija nalog za obdukciju od Državnog tužioca ili Suda, koji sadrži podatke o slučaju, kao i detaljna pitanja za sudskog veštaka.</p> <p>2. Pre obdukcije, sudskom veštaku je</p>
--	--	---

<p>ofrohet qasje në të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me rastin, hetimin në vendin e ngjarjes dhe historikun mjekësor të rastit.</p> <p>3. Në raste të caktuara, mund të jetë e nevojshme konsultimi edhe i specialistëve të tjerë, nëse mjeku ligjor konsideron se një përfshirje e tyre do të ishte një ndihmesë. Për këtë informohet Prokurori i rastit dhe merret aprovimi i tij.</p> <p>4. Nëse është e nevojshme, bëhet edhe incizimi me rëntgen apo përdoren teknikat e imazherisë radiologjike.</p> <p>5. Nëse kërkohet, anëtarëve të afërm të familjes i'u lejohet të shohin trupin.</p>	<p>granted access to all information related to the case, the investigation at the scene and the medical background of the case.</p> <p>3. In certain cases, it may be necessary to consult other specialists, if the forensic doctor considers that their involvement would be helpful. The Prosecutor of the case is informed and his/her approval is obtained.</p> <p>4. If necessary, X-rays or other radiological imaging techniques can be employed.</p> <p>5. If requested, close family members are allowed to see the body.</p>	<p>omogućen pristup svim informacijama u vezi sa slučajem, uviđajem na mestu zločina i medicinskom pozadinom slučaja.</p> <p>3. U određenim slučajevima može biti potrebno konsultovati druge forenzičke specijaliste ili druge specijaliste, ako sudski veštak smatra da bi njihovo učešće bilo od pomoći. O tome se obaveštava tužilac predmeta i dobija se njegovo odobrenje.</p> <p>4. Ako je potrebno, mogu se koristiti rendgenski zraci ili druge tehnike radiološke slike.</p> <p>5. Ako se to traži, članovima uže porodice je dozvoljeno da vide telo.</p>
<p style="text-align: center;">KAPITULLI III PROCEDURA E AUTOPSISË MJEKO LIGJORE</p> <p style="text-align: center;">Neni 12 Identifikimi</p>	<p style="text-align: center;">CHAPTER III FORENSIC AUTOPSY PROCEDURE</p> <p style="text-align: center;">Article 12 Identification</p>	<p style="text-align: center;">POGLAVLJE III POSTUPAK FORENZIČKE OBDUKCIJE</p> <p style="text-align: center;">Član 12 Identifikacija</p>
<p>1. Për të siguruar që identifikimi i trupit të kryhet në pajtim me standardet ndërkombëtare merren parasysh kriteret si në vijim:</p> <p>1.1. njohja vizuale e trupit të pidentifikuar mund të bëhet nga të afërmit ose personat që e kanë njohur dhe</p>	<p>1. In order to ensure that the identification of the body is carried in accordance with international standards, the following criteria are taken into account:</p> <p>1.1. visual recognition of the unidentified body can be done by relatives or persons who have known and recently seen the</p>	<p>1. Kako bi se osiguralo da se identifikacija tela vrši u skladu sa međunarodnim standardima, uzimaju se u obzir sledeći kriterijumi:</p> <p>1.1. vizuelno prepoznavanje neidentifikovanog tela mogu obaviti rođaci ili osobe koje su poznavale i</p>

<p>e kanë parë së fundmi individin e supozuar, por duhet të plotësohet dhe të vërtetohet me mjete të tjera të identifikimit shkencor.</p> <p>1.2. në rastet e identitetit të supozuar, duhet të grumbullohen dhe të regjistrohen në detaje të dhënat antemortem (para vdekjes) duke përfshirë të dhënat dentare, historikun e traumave fizike, të dhënat e imazherisë radiologjike, karakteristikat fizike të njohura apo të dokumentuara;</p> <p>1.3. duhet të evidentohen në detaje gjësendet personale, veshjet, stolitë dhe gjërat e xhepit.</p> <p>1.4. karakteristikat fizike duhet të evidentohen në detaje përmes një ekzaminimi të jashtëm dhe të brendshëm.</p> <p>1.5. ekzaminimi i dhëmbëve kryhet dhe regjistrohet në detaje.</p> <p>1.6. gjurmët e gishtave dhe të pëllëmbës merren nga zyrtarët policor.</p> <p>1.7. mostrat biologjike duhet të merren nga trupi për identifikim gjenetik.</p> <p>1.8. në rastet e trupave në fazë të avancuar të dekompozimit ose të skeletizuar, kryhet ekzaminimi antropologjik mjeko ligjor dhe regjistrohen në detaje</p>	<p>presumed individual, but shall be complemented and confirmed by other means of scientific identification;</p> <p>1.2. in cases where a presumed identity exists, antemortem (before death) data should be collected and recorded in detail, including dental data, history of physical trauma, radiological imaging data, known or documented physical characteristics;</p> <p>1.3. personal belongings, including clothing, ornaments and pocket items shall be recorded in detail;</p> <p>1.4. physical characteristics shall be recorded in detail through an external and internal examination.</p> <p>1.5. dental examination shall be performed and recorded in detail;</p> <p>1.6. fingerprints and palm prints are taken by police officers;</p> <p>1.7. biological samples shall be collected from the body for genetic identification;</p> <p>1.8. in cases of bodies in an advanced stage of decomposition or skeletonized, a forensic anthropological examination shall be performed and identifying</p>	<p>nedavno videle pretpostavljenu osobu, ali će biti dopunjeno i potvrđeno drugim sredstvima naučne identifikacije;</p> <p>1.2. u slučajevima kada postoji pretpostavljeni identitet, antemortem (pre smrti) podatke treba prikupiti i detaljno evidentirati, uključujući stomatološke podatke, istoriju fizičke traume, podatke radiološke slike, poznate ili dokumentovane fizičke karakteristike;</p> <p>1.3. lične stvari, uključujući odeću, ukrase i džepne predmete, moraju se detaljno evidentirati;</p> <p>1.4. fizičke karakteristike će se detaljno evidentirati eksternim i internim pregledom;</p> <p>1.5. stomatološki pregled će se obaviti i detaljno evidentirati;</p> <p>1.6. otiske prstiju i dlanova uzimaju policijski službenici;</p> <p>1.7. biološki uzorci se prikupljaju sa tela radi genetske identifikacije;</p> <p>1.8. u slučajevima tela u podmakloj fazi raspadanja ili skeletizovanja, izvršiće se forenzičko antropološko ispitivanje i</p>
--	---	---

<p>karakteristikat identifikuese.</p> <p style="text-align: center;">Neni 13 Ekzaminimi i jashtëm</p> <p>1. Gjatë ekzaminimit të jashtëm, eksperti mjeko ligjor:</p> <p>1.1. evidenton datën, kohën dhe vendin e autopsisë;</p> <p>1.2. evidenton emrin e ekspertit mjeko ligjor, teknikut të autopsisë, fotografit mjeko ligjor dhe të gjithë personave të tjerë të pranishëm në autopsi duke treguar pozitën dhe rolin e secilit;</p> <p>1.3. siguron që të bëhet fotografimi ose video incizimi sipas rastit të të gjitha gjetjeve përkatëse, si dhe të trupit të veshur dhe të zhveshur;</p> <p>1.4. ekzaminon dhe evidenton veshjet dhe gjësendet personale, si edhe verifikon korrespondencën ndërmjet dëmtimeve në trup dhe veshje, derisa tekniku i autopsisë nën mbikëqyrjen e ekspertit mjeko ligjor, zhveshë rrobat e trupit;</p> <p>1.5. siguron që kur është e nevojshme të bëhen incizime me rëntgen.</p>	<p>characteristics shall be recorded in detail.</p> <p style="text-align: center;">Article 13 External examination</p> <p>1. During the external examination, the forensic expert shall:</p> <p>1.1. record the date, time and place of autopsy;</p> <p>1.2. record the name of the forensic expert the autopsy technician, the forensic photographer and all other persons present at the autopsy, with indication of the position and role of each;</p> <p>1.3. ensure that all relevant findings, as well as the clothed and unclothed body, are photographed or videotaped as the case may be;</p> <p>1.4. examine and record clothing and personal effects, as well as verifies the correspondence between injuries on the body and clothing, while the autopsy technician, under the supervision of the forensic doctor, undresses the body;</p> <p>1.5. ensure that, where appropriate, X-rays are taken.</p>	<p>detaljno evidentirati identifikacione karakteristike.</p> <p style="text-align: center;">Član 13 Eksterno ispitivanje</p> <p>1. Tokom eksternog ispitivanja, sudski veštak će:</p> <p>1.1. evidentirati datum, vreme i mesto obdukcije;</p> <p>1.2. evidentirati ime sudskog veštaka, obduccionog tehničara, forenzičkog fotografa i svih drugih osoba prisutnih na obdukciji, sa naznakom položaja i uloge svakog;</p> <p>1.3. osigurati da se svi relevantni nalazi, kao i odeveno i neodeveno telo fotografišu ili snimaju na video, u zavisnosti od slučaja;</p> <p>1.4. pregledati i evidentirati odeću i lične stvari, kao i proveravati povezanost povreda na telu i odeće, dok obdukcioni tehničar, pod nadzorom sudskog veštaka, svlači telo;</p> <p>1.5. osigurati da se, gde je to potrebno, urade rendgenski snimci.</p>
---	--	---

<p>1.6. nëse është e nevojshme, para fillimit të autopsisë merren strisho nga vrimat natyrale të trupit për të gjetur dhe identifikuar provat biologjike.</p> <p>2. Të gjitha ndryshimet pato-anatomike përshkruhen sipas formës, matjeve, drejtimit, skajeve, këndeve dhe vendndodhjes në raport me pikat referuese anatomike.</p> <p>3. Nëse është e nevojshme, merren mostra nga plagët për analizë të mëtejshme, të tilla si histopatologjia dhe histokimia.</p> <p>4. Përshkruhen shenjat e ndërhyrjeve së fundmi apo të vjetra mjekësore dhe kirurgjikale, si dhe të reanimimit. Pajisjet mjekësore nuk guxojnë të hiqen nga trupi para ekzaminimit nga eksperti mjeko ligjor.</p>	<p>1.6. ensure that, where appropriate and before beginning the autopsy, body orifices are appropriately swabbed for the recovery and identification of biological evidence.</p> <p>2. All patho-anatomical changes are described by shape, measurements, direction, edges, angles, and location relative to anatomical landmarks.</p> <p>3. If necessary, samples are taken from the wounds for further analysis, such as histopathology and histochemistry.</p> <p>4. The signs of recent or old medical and surgical interventions, as well as resuscitation, are described. Medical devices must not be removed from the body before examination by the forensic doctor.</p>	<p>1.6. osigurati da, gde je to prikladno i pre početka obdukcije, iz telesnih otvora budu na odgovarajući način uzeti brisevi radi pronalaženja i identifikacije bioloških dokaza.</p> <p>2. Sve patoanatomske promene opisane su oblikom, merama, smerom, ivicama, uglovima i lokacijom u odnosu na anatomske orijentire.</p> <p>3. Ako je potrebno, uzimaju se uzorci iz rana za dalju analizu, kao što su histopatologija i histochemija.</p> <p>4. Opisani su znaci svežih ili starih medicinskih i hirurških intervencija, kao i reanimacije. Medicinska sredstva se ne smeju vaditi iz tela pre pregleda od strane sudskog veštaka.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 14 Ekzaminimi i brendshëm</p> <p>1. Ekzaminimi i brendshëm i trupit nënkupton hapjen e të paktën tri zgavrave të trupit që përfshinë, por nuk kufizohet në zgavrën e kokës, kraharorit dhe barkut, si dhe ekzaminimin e organeve të brendshme.</p> <p>2. Bëhet përshkrimi i detajuar i organeve dhe zgavrave, si dhe dokumentimi pas ekzaminimit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 14 Internal examination</p> <p>1. Internal examination of the body means the opening of at least three body cavities including, but not limited to, the cavity of the head, chest and abdomen, as well as the examination of the internal organs.</p> <p>2. Detailed description of organs and cavities is done, followed by documentation after the examination.</p>	<p style="text-align: center;">Član 14 Interno ispitivanje</p> <p>1. Interni pregled tela podrazumeva otvaranje najmanje tri telesne šupljine; što uključuje, ali nije ograničeno na šupljinu glave, grudnog koša i abdomena i pregled unutrašnjih organa.</p> <p>2. Uraditi detaljan opis organa i šupljina, a nakon pregleda sledi dokumentacija .</p>

<p>3. Organet largohen nga zgavra trupore nga ana e ekspertit mjeko ligjor ose teknikut të autopsisë.</p> <p>4. Pesha e organeve evidentohet nga ana e ekspertit mjeko ligjor ose teknikut të autopsisë.</p> <p>5. Organet disektohen dhe përshkruhen sipas udhëzimeve standarde.</p> <p>6. Të gjitha lezionet dhe lëndimet e brendshme përshkruhen sipas madhësisë dhe vendndodhjes, në atë mënyrë që përfshin drejtimin e tyre në raport me anatominë e organeve.</p> <p>7. Kafka, kafazi i krahavorit, shtylla kurrizore dhe pleviku ekzaminohen si pjesë e procedurës së autopsisë dhe në rast se është e nevojshme tek vdekjet traumatike, këto dhe kockat e tjera ekzaminohen duke përfshirë edhe kockat e ekstremiteteve si dhe bëhen ekzaminimet me rëntgen.</p>	<p>3. The organs are removed from the body cavity by the forensic doctor or the autopsy technician.</p> <p>4. The weight of the organs is recorded by the forensic doctor or the autopsy technician.</p> <p>5. Organs are dissected and described according to standard guidelines.</p> <p>6. All lesions and internal injuries are described, according to size and location, including their direction in relation to the anatomy of the organs.</p> <p>7. The skull, ribcage, spine and pelvis are examined as part of the autopsy procedure and, if necessary, in traumatic deaths, these and other bones are examined, including the bones of the extremities with x-ray examination.</p>	<p>3. Organe iz telesne šupljine vade sudski veštak ili obdukcioni tehničar.</p> <p>4. Težinu organa beleži sudski veštak ili obdukcioni tehničar.</p> <p>5. Organi se seciraju i opisuju prema standardnim smernicama.</p> <p>6. Opisane su sve lezije i unutrašnje povrede, prema veličini i lokaciji, uključujući njihov smer u odnosu na anatomiju organa.</p> <p>7. U okviru obdukcije se pregledaju lobanja, grudni koš, kičma i karlica, a po potrebi se kod traumatskih smrti pregledaju ove i druge kosti, uključujući i kosti ekstremiteta rendgenskim pregledom.</p>
<p>Neni 15 Mostrat për analiza laboratorike</p>	<p>Article 15 Samples for laboratory tests</p>	<p>Član 15 Uzorci za laboratorijska ispitivanja</p>
<p>1. Mostrat për testim laboratorik merren në mënyrë rutinore, etiketohen dhe ruhen sipas standardeve profesionale.</p> <p>2. Eksperti mjeko ligjor ose tekniku i autopsisë merr mostrat e gjakut, urinës, dhe</p>	<p>1. Samples for laboratory testing are routinely collected, labeled and stored according to professional standards.</p> <p>2. Forensic doctor or the autopsy technician takes samples of blood, urine, and other</p>	<p>1. Uzorci za laboratorijsko ispitivanje se rutinski prikupljaju, označavaju i čuvaju u skladu sa profesionalnim standardima.</p> <p>2. Sudski veštak, obdukcioni tehničar uzima uzorke krvi, urinu i druge telesne tečnosti za</p>

<p>lëngjeve tjera trupore për ekzaminime toksikologjike, biokimike, gjenetike ose të tjera.</p> <p>3.Në secilin rast ku kërkohen analiza toksikologjike duhet të merren së paku dy lëngje trupore të ndryshme si mostër, përveç kur një gjë e tillë është e pamundur.</p> <p>4.Në rastet e dyshimta për helmim, përveç mostrave nga paragrafi 2 i këtij neni mund të merren edhe mostra të tjera sipas nevojës.</p> <p>5.Mostra e gjakut duhet të përshkruhet nëse është marrë nga enët qendrore, periferike ose nga kavitetet.</p> <p>6.Mostrat rutinore për ekzaminim histopatologjik janë: truri, mushkëritë, zemra, mëlçia, shpretka, pankreasi, veshkat dhe gjëndrat mbi veshkore. Vetëm në rastet kur nuk kemi shpjegim të arsyeshëm të shkaktit të vdekjes, eksperti mjeko ligjor kërkon që këto mostra të procedohen dhe të ekzaminohen.</p>	<p>bodily fluids for toxicological, biochemical, genetic, or other examinations.</p> <p>3. In each case where toxicological analyses are required, at least two different bodily fluids must be taken as samples, except when such a thing is impossible.</p> <p>4. In cases of suspected poisoning, in addition to the samples referred to in paragraph 2 of this article, other samples may be taken as needed.</p> <p>5. The blood sample must be described if it was taken from the central, peripheral vessels or from the cavities.</p> <p>6. Routine samples for histopathological examination are: brain, lungs, heart, liver, spleen, pancreas, kidneys and adrenal glands. Only in cases where we do not have a reasonable explanation of the cause of death, the forensic doctor requires that these samples be processed and examined.</p>	<p>toksikološke, biohemijske, genetske ili druge pretrage.</p> <p>3.U svakom slučaju kada su potrebne toksikološke analize, kao uzorci se moraju uzeti najmanje dve različite telesne tečnosti, osim kada je to nemoguće.</p> <p>4. U slučaju sumnje na trovanje, pored uzoraka iz stava 2. ovog člana, mogu se uzeti i drugi uzorci po potrebi.</p> <p>5. Uzorak krvi se mora opisati ako je uzet iz centralnih, perifernih sudova ili iz šupljina.</p> <p>6. Rutinski uzorci za histopatološki pregled su: mozak, pluća, srce, jetra, slezina, pankreas, bubrezi i nadbubrežne žlezde. Samo u slučajevima kada nemamo razumno objašnjenje uzroka smrti, sudski veštak zahteva da se ti uzorci obrade i pregledaju.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 16 Lirimi i trupit</p> <p>1. Pasi kryhet autopsia, trupi pastrohet, vendoset në qese për trupa dhe i kthehet familjes sipas urdhrit të organit që ka urdhëruar autopsinë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 16 Release of the body</p> <p>1.After the autopsy is performed, the body is cleaned, placed in a body bag and returned to the family according to the order of the body that ordered the autopsy.</p>	<p style="text-align: center;">Član 16 Otpuštanje tela</p> <p>1. Nakon obavljene obdukcije, telo se čisti, stavlja u vreću za telo i vraća porodici po nalogu tela koje je naložilo obdukciju.</p>

<p>2. Nëse trupi nuk është identifikuar, mbahet në morg derisa nuk ka një urdhër nga organi përkatës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 17 Përpunimi i provave</p> <p>1. Provat dhe mostrat që janë marrë, të paketuara dhe të etiketuara ruhen në Institut.</p> <p>2. Instituti ruan dhe mirëmban të gjitha provat dhe mostrat e mbledhura gjatë autopsisë në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.</p>	<p>2.If the body has not been identified, it is kept in the morgue until another order is received from the relevant body.</p> <p style="text-align: center;">Article 17 Evidence processing</p> <p>1. Evidence and samples that have been taken, packaged, and labelled are stored at the Institute.</p> <p>2. The Institute preserves and maintains all the evidence and samples collected during the autopsy in accordance with the relevant legislation in force.</p>	<p>2. Ako telo nije identifikovano, čuva se u mrtvačnici do prijema drugog naloga od nadležnog organa.</p> <p style="text-align: center;">Član 17 Obrada dokaza</p> <p>1. U Institutu se čuvaju dokazi i uzorci koji su uzeti, upakovani i obeleženi.</p> <p>2. Institut čuva i skladišti sve dokaze i uzorke prikupljene tokom obdukcije u skladu sa relevantnim zakonima na snazi .</p>
<p style="text-align: center;">Neni 18 Raporti i autopsisë</p> <p>1. Raporti i autopsisë është raport mjekësor i detajuar për kufomën, dhe është pjesë përbërëse e procedurës së autopsisë.</p> <p>2. Raporti i autopsisë duhet të:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1.jetë i plotë, i detajuar, gjithëpërfshirës, objektiv, i qartë dhe i kuptueshëm, jo vetëm për mjekët e tjerë, por edhe për ata që nuk i përkasin fushës së mjekësisë;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. ruhet në kopje fizike, edhe nëse ruhet si kopje elektronike.</p>	<p style="text-align: center;">Article 18 Autopsy report</p> <p>1.The autopsy report is a detailed medical report on the body, and is an integral part of the autopsy procedure.</p> <p>2.The autopsy report shall be:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1.full, detailed, comprehensive, objective, clear and understandable, not only to other doctors, but also to those who do not belong to the field of medicine;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. tored in hard copy, even if stored as electronic copy.</p>	<p style="text-align: center;">Član 18 Obdukcioni nalaz</p> <p>1. Obdukcioni nalaz je detaljan medicinski nalaz o telu i sastavni je deo obdukcionog postupka.</p> <p>2. Obdukcioni nalaz:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1.će biti kompletan, detaljan, sveobuhvatan, objektivan, jasan i razumljiv, ne samo drugim doktorima, već i onima koji ne pripadaju oblasti medicine;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2.se čuva u čitljivom obliku sa štampanim primerkom, kao i u elektronskom formatu.</p>

<p>3. Raporti i autopsisë përbëhet prej katër (4) pjesëve: pjesa e përgjithshme, gjetjet e jashtme dhe të brendshme, gjetjet laboratorike dhe konkluzioni.</p> <p>4. Pjesa e përgjithshme e raportit të autopsisë përmban:</p> <p>4.1. të dhëna të plota personale të të ndjerit duke përfshirë emrin, moshën, gjininë, adresën dhe profesionin, përveç rasteve të paidentifikuara;</p> <p>4.2. datën, vendin dhe kohën e vdekjes, kur dihet;</p> <p>4.3. datën, vendin dhe kohën e autopsisë;</p> <p>4.4. emrin, kualifikimet dhe statusin e ekspertit mjeko ligjor;</p> <p>4.5. personat e pranishëm në autopsi dhe funksionin e tyre;</p> <p>4.6. emrin e mjekut që ka konstatuar vdekjen;</p> <p>4.7. një përmbledhje të historisë dhe rrethanave të vdekjes, siç i janë dhënë mjekut ligjor nga policia, nga gjyqtarët, të afërmit ose persona të tjerë, si dhe informacionet e përfshira në dosje, nëse është në dispozicion;</p>	<p>3.The autopsy report consists of four (4) parts: the general part, external and internal findings, laboratory findings and conclusion.</p> <p>4.The general part of the autopsy report contains:</p> <p>4.1. full personal details of the deceased including name, age, sex, address and occupation, unless unidentified cases;</p> <p>4.2. date, place and time of death, where known;</p> <p>4.3. date, place and time of autopsy;</p> <p>4.4. name, qualifications and status of the forensic doctor;</p> <p>4.5. persons present at the autopsy and their function;</p> <p>4.6. name of the doctor who declared death;</p> <p>4.7.a synopsis of the history and circumstances of the death, as provided to the forensic doctor by the police, judges, relatives or other persons, as well as information contained in the file, where available;</p>	<p>3. Obdukcioni nalaz se sastoji iz četiri (4) dela: opšti deo, nalazi eksternog i internog ispitivanja, laboratorijski nalaz i zaključak .</p> <p>4. Opšti deo obdukcionog nalaza sadrži:</p> <p>4.1.potpuni lični podaci preminulog uključujući ime, godine, pol, adresu i zanimanje osim ako nisu identifikovani;</p> <p>4.2. datum, mesto i vreme smrti, ako je poznato;</p> <p>4.3. datum, mesto i vreme obdukcije;</p> <p>4.4. ime, kvalifikacije i status sudskog veštaka;</p> <p>4.5.osobe prisutne tokom obdukcije i njihova funkcija;</p> <p>4.6. ime doktora koji je utvrdio smrt;</p> <p>4.7. sinopsis istorije i okolnosti smrti, koji su medicinsko-pravnim veštacima dali policija, sudije, rođaci ili druge osobe, kao i informacije sadržane u dosijeu, ako su dostupne;</p>
---	---	--

<p>4.8. përshkrimin e vendit të ngjarjes ku ka ndodhë vdekja, nëse ishte i pranishëm eksperti mjeko ligjor.</p> <p>5. Ekzaminimi i jashtëm duhet të përmbajë përshkrimin e hollësishëm të çdo ndryshimi pato-anatomik sipas regjionit anatomik.</p> <p>6. Ekzaminimi i brendshëm duhet të përmbajë përshkrime të hollësishme për secilin organ sipas sistemeve anatomike.</p> <p>7. Pjesa e gjetjeve laboratorike duhet të përfshijë të gjitha rezultatet nga toksikologjia, identifikimi gjenetik, histopatologjia, dhe analizave tjera. Duhet të përfshihen rezultatet e ekzaminimeve ndihmëse, si radiologjia, odontologjia, entomologjia dhe antropologjia, në rast se janë në dispozicion këto analiza.</p> <p>8. Konkluzioni lidhur me shkakun dhe mekanizmin e vdekjes rrjedh nga të gjitha faktet në raport. Konkluzioni duhet të korrespondojë gjithmonë me faktet në raport dhe nuk duhet të jetë kontradiktor me to.</p> <p>9. Raporti përmban datën e përfundimit dhe nënshkruhet nga eksperti mjeko ligjor. Raporti përgatitet në dy kopje. Një kopje i dërgohet Prokurorit të Shtetit apo Gjykatës dhe një kopje ruhet në arkivën e Institutit bashkë me dosjen e rastit.</p>	<p>4.8. description of the scene of death, if the forensic doctor was present.</p> <p>5. The external examination shall contain the detailed description of any patho-anatomical changes according to the anatomical region.</p> <p>6. The internal examination shall contain detailed descriptions of each organ according to anatomical systems.</p> <p>7. The laboratory findings section should include all results from toxicology, genetic identification, histopathology, and other analyses. The results of ancillary examinations, such as radiology, odontology, entomology and anthropology, shall be included when such tests are available.</p> <p>8. The conclusion regarding the cause and mechanism of death is derived from all the facts in the report. The conclusion shall always correspond to the facts in the report and must not contradict them.</p> <p>9. The report contains the date of completion and is signed by the forensic doctor. The report is prepared in two copies. A copy is sent to the State Prosecutor or the Court and a copy is kept in the archive of the Institute together with the case file.</p>	<p>4.8. opis mesta smrti, ako je bio prisutan sudski veštak.</p> <p>5. Eksterno ispitivanje mora sadržati detaljan opis svih pato-anatomskih promena prema anatomskoj regiji</p> <p>6. Interno ispitivanje mora sadržati detaljne opise svakog organa prema anatomskim sistemima.</p> <p>7. Odeljak laboratorijskih nalaza treba da sadrži sve rezultate toksikoloških, genetičkih identifikacija, histopatoloških i drugih analiza. Rezultate pomoćnih pregleda, kao što su radiologija, odontologija, entomologija i antropologija, treba uključiti kada su takvi testovi dostupni.</p> <p>8. Zaključak o uzroku i mehanizmu smrti proizilazi iz svih činjenica u nalazu. Zaključak uvek mora odgovarati činjenicama u izveštaju i ne sme im biti u suprotnosti .</p> <p>9. Nalaz sadrži datum završetka i potpisan je od strane medicinsko-pravnih veštaka. Nalaz je pripremljen u dva primerka. Kopija se šalje Državnom tužiocu ili Sudu, a kopija se čuva u arhivi Instituta zajedno sa spisima predmeta.</p>
---	--	---

<p align="center">Neni 19 Dosja e rastit të autopsisë</p>	<p align="center">Article 19 Autopsy case file</p>	<p align="center">Član 19 Dosije obdukcije</p>
<p>1. Dosja fizike e arkivuar e secilit rast të autopsisë mjeko ligjore përmban, por nuk kufizohet vetëm në dokumentet si në vijim:</p> <p>1.1. formularin e zinxhirit të ruajtjes nga vendi i ngjarjes;</p> <p>1.2. formularin e pranimit të trupit apo mbetjeve mortore;</p> <p>1.3.kërkesën për ekzaminim histopatologjik;</p> <p>1.4. kërkesën për analiza toksikologjike;</p> <p>1.5. listën kontrolluese për mbledhjen e provave të autopsisë;</p> <p>1.6. formularin për marrjen e mostrave dhe dorëzimin gjatë autopsisë;</p> <p>1.7.formularin e raportit paraprak të policisë;</p> <p>1.8.formularin e përshkrimit dhe dorëzimit të veshjeve;</p> <p>1.9.formularin e konkluzionit të autopsisë;</p>	<p>1. An archived physical file of each forensic autopsy case contains, but is not limited to, the following documents:</p> <p>1.1. chain of custody form from the scene;</p> <p>1.2. the form for receiving the body or mortal remains;</p> <p>1.3. the request for histopathological examination;</p> <p>1.4. the request for toxicological analysis;</p> <p>1.5. checklist for collection of autopsy evidence;</p> <p>1.6. form for sampling and delivery during autopsy;</p> <p>1.7. preliminary police report form;</p> <p>1.8. clothing description and delivery form;</p> <p>1.9. autopsy report form;</p>	<p>1. Arhivirani štampani primerak svakog slučaja forenzičke obdukcije sadrži, ali nije ograničen na, sledeće dokumente :</p> <p>1.1.obrazac lanca čuvanja dokaza na mestu zločina;</p> <p>1.2. obrazac za prijem tela ili posmrtnih ostataka;</p> <p>1.3. obrazac zahteva za histopatološki pregled;</p> <p>1.4. obrazac zahteva za toksikološku analizu;</p> <p>1.5.kontrolna lista za prikupljanje obdukcionih dokaza;</p> <p>1.6.obrazac za uzimanje uzoraka i dostavu tokom obdukcije;</p> <p>1.7.obrazac preliminarne policijske prijave;</p> <p>1.8. obrazac opisa i dostave odeće;</p> <p>1.9. obrazac nalaza obdukcije;</p>

<p>1.10. formularin e raportit të autopsisë;</p> <p>1.11. fletën e fotografisë së autopsisë;</p> <p>1.12. formularin e peshës së organeve;</p> <p>1.13. listën kontrolluese të dosjes së autopsisë;</p> <p>1.14. formularin e kërkesës për çertifikatën e vdekjes;</p> <p>1.15. çertifikatën e vdekjes;</p> <p>1.16. formularin e dorëzimit për raportin përfundimtar të ekzaminimit ose çertifikatën e vdekjes;</p> <p>1.17. çertifikatën e karantinimit;</p> <p>1.18. dokumente të tjera sipas rastit.</p>	<p>1.10. the autopsy report form;</p> <p>1.11. the autopsy photo sheet;</p> <p>1.12. organ weight form;</p> <p>1.13. autopsy file checklist;</p> <p>1.14. death certificate request form;</p> <p>1.15. death certificate;</p> <p>1.16. submission form for final examination report or death certificate;</p> <p>1.17. quarantine certificate;</p> <p>1.18. other documents as appropriate.</p>	<p>1.10. the autopsy report form;</p> <p>1.11. obdukcioni foto list;</p> <p>1.12. obrazac težine organa;</p> <p>1.13. kontrolna lista dosije obdukcije;</p> <p>1.14. zahtev za izdavanje umrlice;</p> <p>1.15. umrlica;</p> <p>1.16. obrazac za podnošenje izveštaja o završnom ispitivanju ili izvod iz matične knjige umrljih;</p> <p>1.17. karantinski sertifikat;</p> <p>1.18. ostala potrebna dokumenta.</p>
<p style="text-align: center;">KAPITULLI IV AUTOPSIA MJEKO LIGJORE NË RASTE TË VEÇANTA</p> <p style="text-align: center;">Neni 20 Procedura për autopsy të veçantë</p>	<p style="text-align: center;">CHAPTER IV FORENSIC AUTOPSY IN SPECIAL CASES</p> <p style="text-align: center;">Article 20 Special autopsy procedures</p>	<p style="text-align: center;">POGLAVLJE IV FORENZIČKA OBDUKCIJA U POSEBNIM SLUČAJEVIMA</p> <p style="text-align: center;">Član 20 Posebni postupci obdukcije</p>
<p>1. Në rastet e vdekjeve të dyshimta që lidhen me embolinë ajrore, pneumotoraks, varje, vdekje të të porsalindurit, helmim, pa u kufizuar edhe në raste të tjera, zbatohen</p>	<p>1. In cases of suspicious deaths related to air embolism, pneumothorax, hanging, death of the newborn, poisoning, without being</p>	<p>1. U slučajevima sumnjivih smrtnih slučajeva vezanih za vazdušnu emboliju, pneumotoraks, vešanje, smrt novorođenčeta, trovanje, bez ograničavanja bilo koje druge</p>

<p>procedura të veçanta për kryerjen e autopsisë.</p> <p>2. Nëse dyshohet për traumë të qafës, truri dhe organet e krahavorit hiqen para se qafa të disektohet, për të mundësuar prerje të detajuara në pjesët pa gjak.</p> <p>3. Nëse ka dyshime për emboli ajri, para autopsisë bëhet radiologjia (me rëntgen) e toraksit dhe fillimisht në këto raste bëhet hapja e pjesshme e krahavorit me procedurë të veçantë në pajtim me standardet profesionale.</p> <p>4. Çdo procedurë e veçantë gjatë autopsisë përshkruhet si pjesë e veçantë në raportin e autopsisë.</p> <p>5. Disektimi në rastet e vdekjes traumatike përfshin disektimin në shtresa dhe paraqitjen e plotë të indeve të buta dhe muskujve, duke përfshirë pjesën e pasme të trupit dhe ekstremitetet.</p> <p>6. Në rastet e vdekjeve të dyshimta në lidhje me sulmet seksuale, organet gjenitale ekzaminohen sipas standardit dhe merren strisho e mostra të indeve për ekzaminime të mëtejshme.</p> <p>7. Pas përfundimit të ekzaminimit në procedurat e veçanta vazhdohet me procedurat si në autopsinë në rastet e tjera.</p>	<p>limited to other cases, special autopsy procedures apply.</p> <p>2. If neck trauma is suspected, the brain and thoracic organs are removed before the neck is dissected, to allow for detailed cuts in the bloodless parts.</p> <p>3. If there are suspicions of an air embolism, radiology (with X-ray) of the thorax is performed before the autopsy and initially in these cases, a partial opening of the thorax is performed with a special procedure in accordance with professional standards.</p> <p>4. Each separate procedure during the autopsy is described as a separate part in the autopsy report.</p> <p>5. Dissection in cases of traumatic death includes dissection in layers and complete presentation of soft tissues and muscles, including the back of the body and extremities.</p> <p>6. In cases of suspicious deaths related to sexual assaults, the genital organs are examined according to the standard and swabs and tissue samples are taken for further examinations.</p> <p>7. After the end of the examination in the special procedures, proceed with the procedures as in the autopsy in other cases.</p>	<p>slučajeve, primenjuju se posebni postupci obdukcije.</p> <p>2. Ako se sumnja na traumiu vrata, mozak i torakalni organi se uklanjaju pre seciranja vrata, kako bi se dozvolili detaljni rezovi na delovima bez krvi .</p> <p>3. Ukoliko postoje sumnje na vazdušnu emboliju, radi se radiologija (sa RTG) grudnog koša pre obdukcije, a u početku se u tim slučajevima radi delimično otvaranje grudnog koša posebnom procedurom u skladu sa stručnim standardima.</p> <p>4. Svaki poseban postupak tokom obdukcije opisan je kao poseban deo u izveštaju o obdukciji.</p> <p>5. Disekcija u slučajevima traumatske smrti uključuje disekciju u slojevima i kompletnu prezentaciju mekih tkiva i mišića, uključujući stražnji deo tela i ekstremitete.</p> <p>6. U slučajevima sumnjive smrti u vezi sa seksualnim napadima, polni organi se pregledaju prema standardu i uzimaju se brisevi i uzorci tkiva za dalja ispitivanja.</p> <p>7. Nakon završenog pregleda u posebnim postupcima, nastavlja se sa postupcima kao na obdukciji u drugim.</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;">KAPITULLI V EKZAMINIMI MJEKO LIGJOR I MBETJEVE NJERËZORE TË SKELETIZUARA</p>	<p style="text-align: center;">CHAPTER V FORENSIC EXAMINATION OF SKELETONIZED HUMAN REMAINS</p>	<p style="text-align: center;">POGLAVLJE V FORENZIČKA ISPITIVANJA SKELETONIZOVANIH LJUDSKIH OSTATAKA</p>
<p style="text-align: center;">Neni 21 Rastet kur kërkohet ekzaminimi mjeko ligjor antropologjik</p> <p>1. Rastet e mbetjeve njerëzore pjesërisht ose plotësisht të skeletizuara me identitet të panjohur ose për shkak të panjohur të vdekjes, dhe të përcaktuara si me interes mjeko ligjor i nënshtrohen ekzaminimit antropologjik mjeko ligjor.</p> <p>2. Interesi mjeko ligjor i mbetjeve njerëzore përcaktohet nga arkeologu mjeko ligjor dhe antropologu mjeko ligjor ose në mungesë të tyre, nga eksperti mjeko ligjor i cili vlerëson periudhën kohore të mbetjeve dhe përcakton nëse mbetjet janë të kohëve të fundit apo historike/parahistorike.</p> <p>3. Interesi mjeko ligjor i mbetjeve njerëzore nga paragrafi 2 i këtij neni përcaktohet në vendin e ngjarjes dhe me mbetjet <i>in situ</i> dhe të patrazuara.</p> <p>4. Mbetjet skeletore jo njerëzore nuk kërkohen ekzaminim antropologjik mjeko ligjor në Institut. Nëse mbetjet skeletore gjenden dhe janë të paqarta për Policinë në vendin e ngjarjes, dhe nëse ato janë</p>	<p style="text-align: center;">Article 21 Cases where forensic anthropological examination is required</p> <p>1. Cases of partially or completely skeletonized human remains of unknown identity or unknown cause of death, and determined to be of forensic interest shall undergo a forensic anthropological examination.</p> <p>2. The forensic interest of human remains is determined by the forensic archaeologist and forensic anthropologist or, in their absence, by the forensic doctor, who assesses the contemporaneity of the remains and determines whether the remains are contemporaneous or historic/prehistoric.</p> <p>3. The forensic interest of human remains from paragraph 2 of this Article is determined at the scene and with the remains <i>in situ</i> and undisturbed.</p> <p>4. Non-human skeletonized remains do not require a forensic anthropological examination at the Institute. If skeletonized remains are found and is unclear to the Police at the scene if they are human, the forensic</p>	<p style="text-align: center;">Član 21 Slučajevi u kojima je potrebno forenzičko-antropološko ispitivanje</p> <p>1. Slučajevi delimično ili potpuno skeletizovanih ljudskih ostataka nepoznatog identiteta ili nepoznatog uzroka smrti, za koje se utvrdi da su od forenzičkog interesa, podvrgavaju se forenzičko-antropološkom ispitivanju.</p> <p>2. Forenzički interes ljudskih ostataka utvrđuje, nakon dostupnosti, forenzički arheolog i forenzički antropolog ili, u njihovom odsustvu, sudski veštak koji procenjuje savremenost posmrtnih ostataka i utvrđuje da su posmrtni ostaci istovremeni, a ne istorijski ili pre-istorijski.</p> <p>3. Forenzički interes ljudskih posmrtnih ostataka iz stava 2. ovog člana utvrđuje se na mestu događaja i sa posmrtnim ostacima na licu mesta i neometano.</p> <p>4. Skeletizovani ostaci koji nisu ljudski ne zahtevaju forenzičko-antropološko ispitivanje u Institutu. Ako se pronađu skeletizovani posmrtni ostaci koji nisu jasni policiji na licu mesta, a ako su u pitanju ljudi,</p>

<p>njerëzore, antropologu mjeko ligjor ose në mungesë të tij, eksperti mjeko ligjor vlerësojnë dhe përcaktojnë natyrën e mbetjeve skeletore.</p> <p>5.Vlerësimi nëse mbetjet skeletore janë njerëzore apo jo njerëzore mund të bëhet përmes fotografive të mbetjeve, të cilat i dërgon Policia nga vendi i ngjarjes. Nëse kjo nuk mund të përcaktohet në këtë mënyrë, eksperti mjeko ligjor ekzaminon dhe përcakton natyrën e mbetjeve në vendin e ngjarjes dhe me mbetjet <i>in situ</i> dhe të patrazuara.</p> <p style="text-align: center;">Neni 22 Zhvarrosja ose tërheqja sipërfaqësore e mbetjeve njerëzore</p> <p>1.Kur gjenden mbetje njerëzore të skeletizuara, antropologu mjeko ligjor ose në mungesë të tij, eksperti mjeko ligjor i caktuar për rastin njoftohet nga Policia që të shkojë në vendin e ngjarjes pa vonesë.</p> <p>2. Zhvarrosja e planifikuar nga një varrë i shënuar dhe i njohur kryhet vetëm me urdhër të Prokurorit të Shtetit apo Gjykatës për qëllime të ekzaminimit mjeko ligjor të mbetjeve.</p> <p>3. Në vendngjarje, zhvarrosja apo tërheqja sipërfaqësore e mbetjeve bëhet nga ekipi mjeko ligjor.</p>	<p>anthropologist or, in his/her absence, the forensic doctor assesses and determines the nature of the skeletonized remains.</p> <p>5. The evaluation of whether the skeletonized remains are human or non-human can be done through photographs of the remains, which the Police sends from the scene. If it cannot be determined in this way, the forensic expert examines and determines the nature of the remains at the scene and with the remains <i>in situ</i> and undisturbed.</p> <p style="text-align: center;">Article 22 Exhumation or surface recovery of human remains</p> <p>1.When skeletonized human remains are found, the forensic anthropologist or, in his/her absence, the forensic doctor assigned to the case is informed by the Police to proceed to the scene without delay.</p> <p>2.The planned exhumation of a known marked grave is only carried out upon the order of the State Prosecutor or the Court for the purpose of forensic examination of the remains.</p> <p>3. At the scene, the exhumation or surface recovery of the remains is done by the forensic team.</p>	<p>forenzički antropolog ili, u njegovom odsustvu, sudski veštak procenjuje i utvrđuje prirodu skeletizovanih posmrtnih ostataka.</p> <p>5.Procena da li su skeletizovani ostaci ljudski ili neljudski može se izvršiti i putem fotografija posmrtnih ostataka koje policija šalje sa lica mesta. Ako se to ne može utvrditi na ovaj način, sudski veštak pregleda i utvrđuje prirodu posmrtnih ostataka na mestu događaja i sa posmrtnim ostacima na licu mesta i posmrtnim ostacima koji nisu pomerani.</p> <p style="text-align: center;">Član 22 Ekshumacija ili površinski oporavak ljudskih ostataka</p> <p>1. Kada se pronađu skeletizovani ljudski ostaci, forenzički antropolog ili, u njegovom odsustvu, sudski veštak koji je određen za slučaj biva obavешten od strane policije da bez odlaganja krene na lice mesta.</p> <p>2. Planirana ekshumacija poznate označene grobnice vrši se samo na zahtev državnog tužioca ili suda radi forenzičkog veštačenja posmrtnih ostataka.</p> <p>3.Na mestu događaja, ekshumaciju ili površinski oporavak ostataka vrši forenzički tim.</p>
--	--	---

<p>4. Ekipi për ekzaminimin në vendin e ngjarjes përbëhet nga së paku një arkeolog ose antropolog mjeko ligjor dhe një zyrtar identifikimi.</p> <p>5. Me kërkesë të antropologut mjeko ligjor të caktuar ose ekspertit mjeko ligjor dhe në varësi të rastit, mund të kërkohet që pjesë të ekipit nga paragrafi 4 të caktohen edhe zyrtarë të tjerë të Institutit.</p> <p>6. Në vendin e ngjarjes, ekspertët mjeko ligjor:</p> <p>6.1. kryejnë një vëzhgim fillestar të zonës pa e trazuar atë;</p> <p>6.2. regjistrojnë vendndodhjen e saktë me një GPS, sipas formatit standard të koordinatave;</p> <p>6.3. realizojnë fotografi të zonës përpara gërmimit ose tërheqjes të mbetjeve të shpërndara në sipërfaqe, duke siguruar që kodi i vendit dhe treguesi verior të jenë të dukshëm në fotografi;</p> <p>6.4. nëse mbetjet janë të shpërndara në sipërfaqe, përcaktojnë shtrirjen, marrin sa më shumë koordinata të GPS që nevojiten, shënojnë dhe numërojnë kockat ose pjesët e trupit individual, si dhe skicojnë, përshkruajnë dhe i fotografojnë përpara se t'i mbledhin ato;</p>	<p>4. The team for the examination at the scene consists of at least one forensic archaeologist or forensic anthropologist and an identification officer.</p> <p>5. At the request of the appointed forensic anthropologist or forensic doctor, and depending on the case, other officials of the Institute may be required to join the team from paragraph.</p> <p>6. At the scene the forensic experts shall:</p> <p>6.1. conduct an initial survey of the area without disturbing it;</p> <p>6.2. record the exact location with a GPS following standard coordinates format;</p> <p>6.3. take photographs of the area prior to excavation or hauling of remains scattered distributed on the surface, ensuring that the site code and north indication is visible on the photographs;</p> <p>6.4. if the remains are scattered over the surface, establish the extent, take as many GPS coordinates as needed, flag and number individual bones or body parts, and sketch, describe and photograph before collecting them;</p>	<p>4. Tim za uviđaj na mestu događaja sastoji se od najmanje jednog arheologa ili forenzičkog antropologa i službenika za identifikaciju.</p> <p>5. Na zahtev imenovanog forenzičkog antropologa ili sudskog veštaka, a u zavisnosti od slučaja, timu iz stava 4. ovog člana mogu se tražiti i druga službena lica Instituta.</p> <p>6. Na licu mesta, sudski veštaci će:</p> <p>6.1. izvršiti početno ispitivanje područja bez ometanja;</p> <p>6.2. evidentirati tačnu lokaciju pomoću GPS-a sledeći standardni format koordinata;</p> <p>6.3. Snimiti fotografije područja pre iskopavanja ili izvlačenja ostataka razbacanih po površini, osiguravajući da su šifra lokacije i oznaka severa vidljivi na fotografijama;</p> <p>6.4. ako su ostaci razbacani po površini, odrediti opseg, uzeti onoliko GPS koordinata koliko je potrebno, označiti i numerisati pojedinačne kosti ili delove tela i skicirati, opisati i fotografisati pre prikupljanja;</p>
--	--	--

<p>6.5. nëse eshtrat janë varrosur në varre të shënuara ose të fshehura, regjistrojnë vendndodhjen e saktë të varrit me koordinatat GPS identifikojnë mbushjen e varrit duke ruajtur, nëse është e mundur, prerjen origjinale dhe skicojnë, përshkruajnë dhe fotografojnë ndërsa gërmimi vazhdon;</p> <p>6.6.gjatë gërmimit të mbetjeve të varrosura, identifikojnë çdo provë fizike me interesit të mundshëm mjeko ligjor dhe shënojnë, numërojnë, skicojnë, përshkruajnë dhe fotografojnë përpara se t'i mbledhin ato;</p> <p>6.7.pasi të kenë arritur mbetjet e varrosura, pastrojnë ato sa më shumë që të jetë e mundur dhe skicojnë, përshkruajnë dhe fotografojnë përpara se të mbledhin ato;</p> <p>6.8. pasi të jenë tërhequr mbetjet dhe varreza të jetë bosh, marrin matjet tredimensionale të varrit dhe skicojnë, përshkruajnë dhe fotografojnë varrezën;</p> <p>6.9. mbetjet e tërhequra në vendin e ngjarjes vendosen në një qese trupi të etiketuar me kodin dhe datën përkatëse, dhe fotografohen përpara bartjes nga vendi i ngjarjes;</p>	<p>6.5. if the remains are buried in either marked or concealed graves, record the exact location of the grave with GPS coordinates, identify the fill of the grave preserving, if possible, the original cut, and sketch, describe and photograph as the excavation proceeds;</p> <p>6.6. during excavation of buried remains, identify any physical evidence of potential forensic interest, and flag, number, sketch, describe and photograph before collecting them;</p> <p>6.7. once buried remains are reached, clean them as much as possible and sketch, describe and photograph before collecting them;</p> <p>6.8. once the remains are recovered and the grave is empty, take tridimensional measurements of the grave and sketch, describe and photograph the grave;</p> <p>6.9. the remains recovered at the scene shall be placed in a body bag labeled with the respective site code and date, and photographed before transfer from the scene;</p>	<p>6.5. ako su posmrtni ostaci pokopani u označenim ili skrivenim grobnicama, zabeležiti tačnu lokaciju grobnice sa GPS koordinatama, identifikovati ispunu grobnice čuvajući, ako je moguće, originalni rez i skicirati, opisati i fotografisati kako se iskopavanje odvija;</p> <p>6.6.tokom iskopavanja zakopanih posmrtnih ostataka, identifikovati sve fizičke dokaze od potencijalnog forenzičkog interesa i označiti, numerisati, skicirati, opisati i fotografisati pre fotografisanja;</p> <p>6.7. kada dođe do zakopanih ostataka, očistite ih što je više moguće i skicirati, opisati i fotografisati pre prikupljanja;</p> <p>6.8. nakon što se posmrtni ostaci pronađu i grob bude prazan, evidentirati trodimenzionalne mere groba i skicirati, opisati i fotografisati grob;</p> <p>6.9. posmrtni ostaci pronađeni na mestu događaja stavljaju se u vreću za telo s oznakom odgovarajućeg mesta i datumom i fotografišu pre premeštanja sa lica mesta.</p>
---	--	---

<p>7. Provat fizike të lidhura drejtpërdrejtë me eshtrat merren nga ekspertët mjeko ligjor dhe së bashku me mbetjet transportohen në morgun e Institutit, ku ruhen në kushte të përshtatshme, të patrazuara dhe me qasje të kufizuar.</p> <p>8. Zinxhiri i ruajtjes së mbetjeve dhe të gjitha provave të tjera fizike të gjetura regjistrohen në mënyrë adekuate dhe dokumentohet transferimi nga vendi i ngjarjes.</p> <p style="text-align: center;">Neni 23 Ekzaminimi mjeko ligjor i mbetjeve njerëzore të skeletizuara</p> <p>1. Qëllimi i ekzaminimit të mbetjeve njerëzore të skeletizuara është përcaktimi ose vërtetimi i identitetit dhe përcaktimi i shkakut të mënyrës së vdekjes sipas urdhërit të Prokurorit të Shtetit apo Gjykatës.</p> <p>2. Ekzaminimi mjeko ligjor i mbetjeve njerëzore të skeletizuara kryhet në Institut.</p> <p>3. Përrjashtimisht, me urdhër të Gjykatës ose të Prokurorit të Shtetit, ekzaminimi paraprak mund të bëhet edhe jashtë Institutit, me kusht që të krijohen kushte të përshtatshme. Ekzaminimi i hollësishëm dhe i plotë kryhet në Institut sapo mbetjet të barten në Institut.</p>	<p>7. Physical evidence directly associated with the remains is recovered by the forensic experts and transported to the Institute's morgue together with the remains, where they are stored in adequate conditions, undisturbed and with limited access.</p> <p>8. The chain of custody of the remains and of all other physical evidence recovered shall be adequately recorded and the transfer from the scene is documented.</p> <p style="text-align: center;">Article 23 Forensic examination of skeletonized human remains</p> <p>1. The purpose of the examination of skeletonized human remains is to determine or to confirm the identity and to determine the cause and manner of death according to the order of the State Prosecutor or the Court.</p> <p>2. The forensic examination of skeletonized human remains is performed at the Institute.</p> <p>3. Exceptionally, by order of the Court or State Prosecutor, a preliminary examination can also be carried outside the Institute, provided that appropriate conditions are established. A thorough and complete examination shall follow at the Institute as soon as the remains can be transferred to the Institute.</p>	<p>7. Fizičke dokaze koji su direktno povezani sa posmrtnim ostacima prikupljaju forenzičari i zajedno sa posmrtnim ostacima transportuju u mrtvačnicu Instituta, gde se čuvaju u adekvatnim uslovima, neometani i sa ograničenim pristupom.</p> <p>8. Lanac čuvanja posmrtnih ostataka i svih drugih pronađenih fizičkih dokaza će biti na odgovarajući način evidentiran, a premeštanje s mesta događaja dokumentovano.</p> <p style="text-align: center;">Član 23 Forenzičko ispitivanje skeletizovanih ljudskih ostataka</p> <p>1. Svrha pregleda skeletizovanih ljudskih ostataka je utvrđivanje ili potvrđivanje identiteta i utvrđivanje uzroka i načina smrti po nalogu Državnog tužioca ili Suda .</p> <p>2. Forenzičko ispitivanje skeletizovanih ljudskih ostataka vrši se u Institutu .</p> <p>3. Izuzetno, po nalogu suda ili državnog tužioca, preliminarni ispit se može obaviti i van Instituta, pod uslovom da se stvore odgovarajući uslovi. U Institutu će uslediti temeljno i potpuno ispitivanje čim posmrtni ostaci budu prebačeni u Institut.</p>
---	--	--

